

VENDIM
Nr.872, datë 18.6.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.618, DATË 7.9.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 1, e 20, pika 3, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Masa e përfitimit për personat me aftësi të kufizuar, të përcaktuar sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, është 8 700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet, çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi.”.

b) Në pikën 9 fjalët “...përfitojnë 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj...” zëvendësohen me “...përfitojnë pagesë sa dyfishi i masës së përfitimit, të përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi...”.

c) Në pikën 10 fjalët “...përfitojnë 21 000 (njëzet e një mijë) lekë në muaj...” zëvendësohen me “...përfitojnë pagesë sa trefishi i masës së përfitimit, të përcaktuar në pikën 8 të këtij vendimi...”.

ç) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Pagesa e kujdestarit të personit me aftësi të kufizuar, sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, është në masën 8 700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet, çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e kësaj pagese të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi.”.

d) Pika 15 shfuqizohet.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 240 (dyqind e dyzet) milionë lekë, të përballohen nga fondi i buxhetit të vitit 2008, grupi 25, titulli 064, kapitulli 1, artikulli 606, zëri “Transferta të familjeve dhe të individëve”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha